



Në bazë të nenit 7, alinea 9 nga Ligji për themelimin e Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16 dhe 164/18), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural shpall

**THIRRJE PUBLIKE nr. 08/2018**

**për parashtrimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018**

**I. LËNDA E SHPALLJES**

Lënda e kësaj shpallje është dhënia e mbështetjes financiare për masat në vijim :

Grupi i masave	Titulli i masës	Vlera maksimale e kostove të pranueshme për përdorues
Masa 123	Investime për përpunim dhe marketing të produkteve bujqësore	7.000.000,00
Nën masa 123.3	- Investime në infrastrukturën e tregut për aktivitetet pas korrjeve	

**II. TË DREJTË NË SHFRYTËZIMIN E MJETEVE**

Të drejtë në shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjekte
Mbështetja është e paraparë për investime publike nga ana e subjekteve shtetërore, partneriteti publik privat ose njësitë e vetëqeverisjes lokale.

**III. SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE**

Mbështetja financiare paguhet sipas parimit të financimit të investimeve të kryera nga ana e përdoruesit në shumën prej 100% nga vlera e shpenzimeve të pranueshme për investim, por jo më shumë se 7.000.000,00 denarë.

**IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI QË PARASHTROHET**

Kërkesat për masat individuale parashtrihen në formën origjinal.

**Një përdorues mund të parashtojë më së shumti 3 kërkesa individuale për masa të ndryshme duke marrë parasysh të gjithë masat nga Programi për mbështetje financiare për zhvillimin rural për vitin 2018.**

Kushte të cilat duhet ti plotësojnë aplikuesit e mjeteve janë të përcaktuara me:

- Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/18, 100/18, 127/18, 172/18 dhe 193/18)
- Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17 dhe 83/18),
- Rregullorja për kushtet e përafërta shtesë për mbështetje nga masat për zhvillimin rural, kostot e pranueshme dhe shuma e mbështetjes për kostot e pranueshme për përdorues për masë individuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 72/14, 88/15, 35/16 dhe 59/16)
- Rregullorja për kriteret më të përafërta për zgjedhje të përdoruesve për masat për zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17, 162/18 dhe 178/18)  
Aplikuesit të cilët i përmbushin rregullat për shfrytëzim të mjeteve për masën 124 renditen në pajtim me kushtet të përcaktuara nga Rregullorja për kriteret më të përafërta për zgjedhje të përdoruesve për masat për zhvillim rural.
- Kërkesat renditen sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës
- Aplikuesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të marrëveshjes për ko-financim me Agjencinë.

**V. MARRJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIME**

Formularët "Kërkesë për mbështetje financiare" së bashku me listën e dokumenteve të duhura dhe Udhëzimi për përdoruesit mund të merren në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk),

Formularët e lartpërmendur mund të merren direkt në Agjenci çdo ditë pune nga ora 08:30 deri 16:30 në adresën:

**Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural**  
**bul. " 3-ta Makedonska brigada" nr. 20**  
**(ndërtesa e Makedonija Tabak bllok C)**  
**1000 Shkup**

**VI. MËNYRA E PARASHTRIMIT TË DOKUMENTEVE**

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018 së bashku me dokumentacionin e duhur të parashtrihen në gjuhën maqedonase, në zarf të mbyllur në të cilin në anën e përparshme në këndin e lartë të majtë të qëndrojnë shkrimi "MOS E HAP" për thirrje Publike numër 08/2018 dhe theksimi i shifrës së masës/nën-sektor për të cilin parashtrihet kërkesa. Kërkesa mund të parashtrihet përmes postës së rekomanduar



## AGJENCIA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për keqpërdorimin ose hapjen e parakohshme të kërkesës.

**Afati i fundit për parashtrim të kërkesës është 08.12.2018.**

**Kërkesat e parashtruara pas afatit të paraparë nuk do të mbikëqyren.**

Informata më të hollësishme në numrin kontaktues: (02) 3097-460 ose në e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe në ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Kontakt:

**Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
Sektori për miratimin e projekteve.**

Telefon 02 3097-460, çdo ditë pune nga ora **08:30** deri **16.00**

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)